

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Themeluesit e Shoqërisë “Nordek” më dt. 06.04.2022 nxjerrin:

## **STATUTIN**

**E**

**“NORDEK” SH.P.K.**

**Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**

**Tiranë**

A handwritten signature or mark, possibly a stylized 'N' or 'D', is written in black ink at the bottom right of the page.

## KREU I

### EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, ADRESA

#### Neni 1

##### Dispozitat e përgjithshme

1.1. Me këtë Statut rregullohen këto çështje :

- a) themelimi dhe emërtimi i Shoqërisë;
- b) lloji i shoqërisë;
- c) adresa e selisë së saj;
- d) periudha e kohëzgjatjes;
- e) veprimtaria e shoqërisë;
- f) organet drejtuese;
- g) emrat dhe adresat e themeluesve; dhe
- h) procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.

#### Neni 2

##### Themelimi dhe Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

2.1. Emërtimi i plotë i shoqërisë është: Shoqëria Tregtare **“NORDEK”** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shkurtimisht: **“NORDEK” sh.p.k.**, e cila këtu e më poshtë do të quhet Shoqëria. Ajo është krijuar me datë 06.04.2022 nga ortaku i vetëm dhe themeluesi, Eduardo Gjana, shtetas shqiptar, i biri i Petritit dhe i Shines, lindur në Malqene, Kukës dhe banues në Tiranë, mbajtës i pashportës Nr. BJ1133541 dhe Nr. Personal J20218044G, me ditëlindje 18.02.1992.

2.2. Ortaku i vetëm ka vendosur miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të Legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.


#### Neni 3

##### Forma dhe baza ligjore e Shoqërisë

3.1. Shoqëria Tregtare është sipas formës ligjore Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, shkurtimisht **SH.P.K.**

3.2. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat ligjore të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3.3. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo lloji ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.



#### Neni 4

#### Adresa e Selisë

4.1. Selia qëndrorë e Shoqërisë është në adresën: “Rruga Shehu, Nd. 028; Domje; 1053; Bashkia Vorë; Qarku Tiranë.”

4.2. Shoqëria mund të themelojë degë (filiale), zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 5

#### Periudha e kohëzgjatjes së Shoqërisë

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë në afat të pacaktuar, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

#### Neni 6

#### Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

6.1. Objekti i veprimtarë së shoqërisë do të jetë:

“Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. - Veprimtari tregtare dhe industriale, import dhe eksport të mirash, shërbimesh dhe produktesh; - Çdo aktivitet tregtar, shitje me shumicë dhe pakice të mallrave dhe/ose shërbimeve.; - Konsulencë në fusha të ndryshme: financiare, doganore, logjistike, ndërmjetësime ndërmjet shoqërive shqiptare dhe të huaja, etj.; - Sipërmarrje dhe investime në sektorë të ndryshëm, veprimtari në fushën e ndërtimeve dhe rikonstruksioneve, transporte të ndryshme, projektme, studime të ndryshme, etj.”

6.2. Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6.3. Për kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur, në rast se do të nevojiten autorizime përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këto autorizime nga organi/institucioni kompetent.

## KREU II KAPITALI


#### Neni 7

#### Kapitali themeltar

7.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.

7.2. Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a) **Ortaku themelues, Z. Eduardo Gjana**, i cili zotëron 100% të numrit total të pjesëve, të barabartë me një pjesë.



7.3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta).

#### **Neni 8**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

8.1. Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm dhe sipas mënyrave dhe rregullave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

#### **Neni 9**

### **Transferimi i kapitalit**

9.1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në qoftë se ortaku i vetëm vendos për këtë. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## **KREU IV**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 10**

### **Organi vendimmarrës**

10.1. Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

10.2. Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

10.3. Asambleja e Ortakut të Vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjen e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c) dhe d) të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- j) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 11 Administrimi

**11.1.** Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit


**11.2.** Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të shoqërisë, deri në emërimin tjetër:

Të dhënat e identifikimit:

(mbiemri, emri, adresa):

- Gjana, Eduardo, Tiranë

dhe specimenët e nënshkrimit:



## Neni 12

### Kompetencat e Administratorëve


Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentacionit dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe shkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimarisë dhe, së bashku më propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe egzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e verpimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

## Neni 13

### Përgjegjësitë e Administratorit

**13.1.** Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.



**13.2.** Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

**13.3.** Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme rë detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedi;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merrret vendimi;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

## **KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTËT**

### **Neni 14 Viti financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me datë 1 (një) Janar dhe përfundon me datë 31 (tridhjetë e një) Dhjetor.

### **Neni 15 Ekspertët**


**15.1.** Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

**15.2.** Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t’ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **Neni 16 Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) me vendim të Asmablesë së Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;



- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin përcaktojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) ose më shumë likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatrit dhe emërtesen shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

#### **Neni 17**

### **Riorganizimi i shoqërisë dhe bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

#### **Neni 18**

### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

## **ORTAKU**

### **I**

### **VETËM**

## **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “NORDEK”**

**Eduardo Gjana**

